



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË

Nr. 187/2 prot.

Himarë, më 24.01.2023

**Lënda:** Njoftim për paraqitjen e dokumentacionit pronësor pranë bashkisë Himarë, për zonën që preket nga projekti : “ITUN Himarë, RWS IIV, LOTI 3 “.

Për arsye të vazhdimit të shpronësimit për realizimin e projektit “ITUN Himarë, RWS IIV, LOTI 3 “, i cili ka për qëllim përmirësimin e sistemit të furnizimit me uje të pijshem dhe të shkarkimit të ujrave të zeza, ju informojme se pas komunikimeve tona me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Vlorë, nga ky institucion nuk përcaktohen prona private në këtë zonë, por vetëm shtetërore.

Duke u nisur nga informacione të ardhura në mënyrë individuale pranë bashkisë për dokumenta pronësore të leshuara nga organet kadastrale në zonën e sipërpërmendur, ju kërkohet se nëqoftëse në këtë zonë të interesit ka pronarë të cilët preken nga ky projekt dhe disponojnë vërtetim hipotekor, keto dokumentacione së bashku me hartat përkatëse duhet të dorëzohen pranë Bashkisë Himarë.

Ju faleminderit.

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro

